



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Drzavnog Tuzioca / Office
of the Chief State Prosecutor

AD.nr.11/2024

Dt. 28 Janar 2025

Prishtinë

Në kuptim të nenit 9 par.1,nënp.1.4 lidhur me par. 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve(Ligji.nr.06/L-057), në lidhje me ankesën e [REDACTED] të dt.22.12.2024, në raport me [REDACTED] unë si autoritet kompetent, nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e [REDACTED] e dt.22.12.2024, në raport me [REDACTED] lidhur me pretendimet se i njëjti të mos ketë qenë në nivelin e trajtimit objektiv e profesional të kërkesave të kësaj pale për paisje me shkresat e lëndëve penale: [REDACTED] dhe [REDACTED] në të cilat kjo palë kishte qenë në cilësinë e palës së akuzuar, ngase pretendimet ankimore të palës ankuese në fjalë nuk kanë të bëjnë me ndonjë shkelje të mundshme disiplinore.

A r s y e t i m

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit-U.D. Kryeprokurori i Shtetit më dt.30 Dhjetor 2024, nga Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës z.Ardian Hajdaraj përmes aktit përcjellës: [REDACTED] të dt.30.12.2024, ka pranuar për trajtim parashtrësën-ankesën e karakterit disiplinor të palës: [REDACTED] të dt.22.12.2024, përmes të cilës parashtrësë kjo palë kishte ngritur pretendimet e veta në raport me [REDACTED] si dhe dy prokurorët e shtetit në të njëjtën prokurori: [REDACTED] se të njëjtit të mos kenë qenë në nivelin e trajtimit profesionale e objektiv të kërkesave të kësaj pale ankuese për paisje me shkresat e lëndëve penale: [REDACTED] në të cilat kjo palë ankuese kishte qenë në cilësinë e palës së akuzuar.

Kronologjia e fakteve të rastit:

-Pala ankuese: [REDACTED] në ankesën e karakterit disiplinor-profesional në raport me [REDACTED] kishte ngritur pretendimet e veta se i njëjti [REDACTED] të mos ketë qenë në nivelin e trajtimit profesional e objektiv të kërkesave të kësaj pale ankuese për paisje me shkresat e lëndëve penale: [REDACTED] dhe [REDACTED] në të cilat kjo palë ankuese kishte qenë në cilësinë e palës së akuzuar.

-Në kontekst të shqyrtimit dhe analizimit të pretendimeve ankimore të parashtruara në ankesën e sipër cekur të palës ankuese, Unë si autoritet kompetent, në kuptim të dispozitës së nenit 9 par.1 nënpar.1.4 dhe par.6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji.nr.06/L-057), kam ndërmarrë veprimet e parashikuara ligjore në raport me [REDACTED] ashtu që nga i njëjti, sipas shkrësës zyrtare: [REDACTED] të dt.09 Janar 2025, kam kërkuar raport të detajuar me shkrim rreth statusit-epilogut të trajtimit të çështjeve procedurale penale të sipërcekura, ndërsa sa i përket prokurorëve të përfshirë në ankesë [REDACTED], çështja i është dërguar në kompetencë [REDACTED] për të vendosur si autoritet kompetent.

-Në ndërkohë, më dt.24 Janar 2025, nga [REDACTED] lidhur me çështjen e kërkuar si më lartë përmes email-it zyrtar kam pranuar raportin e detajuar me shkrim të dt.24 Janar 2025, rreth ecuresë së trajtimit të dy çështjeve procedurale penale: [REDACTED] dhe [REDACTED]

-Nga përmbajtja e raportit të sipërcekur me shkrim të [REDACTED] rreth ecuresë së trajtimit të çështjeve procedurale penale të sipërcekura, rezulton kjo gjendje e fakteve:

-Lidhur me çështjen penale: [REDACTED] me të cilën ka qenë i ngarkuar prokurori i shtetit [REDACTED] çështje kjo e iniciuar përmes kallëzimit penal të Policisë së Kosovës-Njësi i Hetimeve [REDACTED] me [REDACTED] kundër të dyshuarit [REDACTED] në drejtim të veprës penale: Uzurpimi i pronës së paluajtshme sipas nenit 320 par.1 të KPRK-së, kallëzim penal ky i pranuar në të njëjtën prokurori më dt.17.03.2023, ishin zhvilluar hetimet penale në drejtim të asaj veprë penale në fjalë. Pas përfundimit të hetimeve penale meqë ishte arritur kriteri ligjor i dyshimit të bazuar mirë të kryerjes së veprës penale më dt.27.10.2023 ishte ngritur aktakuza kundër të njëjtës palë për të njëjtën vepër penale të sipërcekur.

-Po ashtu, lidhur me çështjen penale: [REDACTED] me të cilën ka qenë e ngarkuar [REDACTED] çështje kjo e iniciuar përmes kallëzimit penal të Policisë së Kosovës-Njësi i Hetimeve [REDACTED] me nr [REDACTED] kundër të dyshuarit [REDACTED] në drejtim të veprës penale: Uzurpimi i pronës së paluajtshme sipas nenit 320 par.1 të KPRK-së, kallëzim penal ky i pranuar në të njëjtën prokurori më dt.30.08.2024, meqë sipas vlerësimit të prokurores së çështjes në fjalë ishte arritur kriteri ligjor i dyshimit të bazuar mirë të kryerjes së veprës penale më dt.19.09.2024 ishte ngritur aktakuza e drejtpërdrejtë kundër të njëjtës palë për vepër penale të sipërcekur.

Më dt.05.11.2024, pala ankuese [REDACTED] kishte bërë një parashtrësë ankimore të [REDACTED], kundër prokurores së shtetit [REDACTED]. Pretendimet e kësaj pale ankuese kishin konsistuar në faktin që pa të drejtë ishte akuzuar drejtpërdrejtë në çështjen penale [REDACTED] dhe kishte kërkuar që të zhvilloheshin hetimet penale në këtë çështje. Veç tjerash ndaj prokurores së çështjes [REDACTED] kishte shprehur animozitet me shprehjet se kinse "E njëjta është e sëmure psikikisht". Po ashtu pala ankuese [REDACTED] sipas shkresës-parashtrësës ankuese të dt.07.11.2024, iu kishte drejtuar gjyqtarës së [REDACTED] znj. [REDACTED], e cila kishte në gjykim e sipër rastin e sipërcekur penal duke potencuar faktin kinse nuk i kishte në dispozicion të gjitha shkresat e asaj lënde penale [REDACTED].

Gjithashtu, pala ankuese [REDACTED] më dt.22.10.2024, kishte bërë kërkesë për përjashtimin e prokurores së shtetit [REDACTED] nga trajtimi i këtij rasti penal [REDACTED], me pretendimet se e njëjta nuk është e paanshme në raport me të njëjtën palë ankuese dhe se prokurorja e shtetit në fjalë po ia zhduk shkresat e lëndës. E njëjta palë ankuese gjithashtu kishte potencuar faktin pretendues se "Po frikësona nga ajo se është e sëmure psikikisht e mos po më gjuan me farë guri në rrugë"

[REDACTED] më dt.14.11.2024, lidhur me këtë çështje-kërkesë për përjashtim, kishte marr aktvendimin për refuzimin e të njëjtës, ngase pala në fjalë nuk kishte ofruar asnjë provë relevante që do të argumentonte përjashtimin e prokurores së shtetit në fjalë. Po ashtu, pala ankuese [REDACTED] kishte parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore të dt.27.08.2024, kundër prokurores së shtetit [REDACTED] në raport me të njëjtën çështje të sipërcekur penale. Kështu pas shqyrtimit të asaj kërkesë sipas vendimit [REDACTED] të dt.09.09.2024, [REDACTED] kishte hedhur si të pabazuar kërkesën e tillë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj prokurores së shtetit [REDACTED].

Andaj, në këtë gjendje të fakteve, kam ardhur në përfundimin se pretendimet e palës ankuese [REDACTED], të parashtruara në raport me [REDACTED] konsistojnë kryesisht në vlerësimin e tij të lirë e subjektiv, ngase sipas fakteve të elaboruara si më lartë, rezulton se subjekti i kësaj ankese: [REDACTED], me asnjë nga veprimet e tija nuk kishte kryer ndonjë nga shkeljet e pretenduara të natyrës disiplinore apo profesionale, përkundrazi i njëjti subjekt iu kishte përmbajtur të gjitha kriteret të parashikuara ligjore, profesionale dhe etike me rastin e trajtimit të kërkesave të sipërcekura të parashtruara nga pala ankuese [REDACTED], andaj, duke u bazuar në atë që u theksua më sipër, kam konsideruar se pretendimet e palës ankuese: [REDACTED], në raport me subjektin e këtij rasti disiplinor: nuk janë të bazuara dhe për këtë arsye kjo çështje ankimore-disiplinore konsiderohet e mbyllur: A.Ë.

Besim Kelmendi
U.D. Kryeprokuror i Shtetit

